



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministrit të Drejtësisë – Ured Ministra Pravde – Office of Minister of Justice

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK)-nr.14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe në pajtim me nenin 10 (paragrafi 4) të Rregullores (QRK) - Nr. 17/2024 për Punën e Qeverisë, Ushtruesi i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Legjislativ për Projekt Aktet Nënligjore për vitin 2026.
2. Plani nga pika 1 e këtij vendimi përfshinë Projekt Aktet Nënligjore, si në vijim:
 - 1.1.Projekt Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Funksionimin e Avokaturës Shtetërore (31.03.2026);
 - 1.2.Projekt Udhëzim Administrativ për tarifat dhe kompensimin e shërbimeve të kryera nga avokatët lidhur me shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas (30.04.2026);
 - 1.3.Projekt Udhëzim Administrativ për procedurat e angazhimit të avokatëve në shërbimet e autorizuara të ndihmës juridike falas (30.04.2026);
 - 1.4.Projekt Rregullore për ndërprerjen e kërimit të personave të zhdukur (25.08.2026);
 - 1.5.Projekt Udhëzim Administrativ për kriteret dhe afatet kohore të përpilimit të raporteve dhe mbikëqyrjes së personave të liruar me kusht (25.03.2026);

- 1.6. Projekt Udhëzim Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 01/2019 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të noterisë i plotësuar dhe ndryshuar më udhëzimin administrativ MD-Nr.11/2023 (31.03.2026);
- 1.7. Projekt Udhëzim Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 04/2019 për mbikëqyrjen, përgjegjësinë dhe procedurën disiplinore të ndërmjetësuesve (29.05.2026);
- 1.8. Projekt Udhëzim Administrativ për punën e Komisionit dhe kriteret e vlerësimit për provimin e Jurisprudencës (31.08.2026);
- 1.9. Projekt Udhëzim Administrativ për përmbajtjen e procesverbalit, formularit të certifikatës për dhënien e provimit, dhe përmbajtja e evidences për provimin e dhënë të Jurisprudencës (31.08.2026);
- 1.10. Projekt Udhëzim Administrativ për rregullimin e procedurës disiplinore për Ekspertët Gjyqësor (31.03.2026)
- 1.11. Projekt Udhëzim Administrativ për tarifën për kryerjen e ekspertizës dhe kompensimin e shpenzimeve të shërbimit për ekspertët gjyqësor (31.03.2026);
- 1.12. Projekt Udhëzim Administrativ për kartelën identifikuese të ekspertëve gjyqësor (31.03.2026);
- 1.13. Projekt Udhëzim Administrativ për ruajtjen e rezultateve të ekzaminimit molekular dhe gjenetik (31.03.2026);
- 1.14. Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën e mirëmbajtjes, sigurisë dhe përdorimit të sistemit dhe nxjerrjen e raporteve publike duke siguruar konfidencialitetin për viktimën (30.06.2026);
- 1.15. Projekt Udhëzim Administrativ për Shërbimet e Integruara (31.03.2026);
- 1.16. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurën e caktimit të kujdestarisë, llojet e kujdestarisë dhe çështjeve të tjera lidhur me kujdestarinë (31.03.2026);
- 1.17. Projekt Udhëzim Administrativ për shërbimet e strehimit llojet e strehimit, llojet dhe numrin e përfituesve të vendosur, dhe çështjet tjera lidhur me strehim (31.03.2026);
- 1.18. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurat për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në procesin e adoptimit (29.05.2026);

- 1.19. Projekt Udhëzim Administrativ për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në procesin e mbështetjes së jetesës së pavarur dhe të mbikëqyrur dhe aftësimin për jetën dhe punën e pavarur (30.04.2026);
- 1.20. Projekt Rregullore për kushtet minimale për themelimin e institucioneve të shërbimeve sociale (29.05.2026);
- 1.21. Projekt Rregullore për organizimin, përgjegjësitë, llojin dhe numrin e profesionistëve si dhe funksionimi i Qendrës për Punë Sociale (30.06.2026);
- 1.22. Projekt Rregullore për organizimin dhe fushëveprimin e qendrave për kujdes ditor (30.04.2026);
- 1.23. Projekt Rregullore për organizimin dhe fushëveprimin e qendrave për pranim (31.08.2026);
- 1.24. Projekt Udhëzim Administrativ për shërbimet sociale dhe familjare nga vullnetarët (30.09.2026);
- 1.25. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurën për dhënien, përsëritjen, pezullimin dhe marrjen e licencës (30.04.2026);
- 1.26. Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën e inspektimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare (30.11.2026);
- 1.27. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurën, kushtet dhe parimet e zbatimit të partneritetit publiko-privat në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare (30.11.2026);
- 1.28. Projekt Udhëzim Administrativ për mbajtjen e evidencës unike dhe të dokumentacionit të përfituesve të të drejtave, formës, masave dhe shërbimeve nga përkujdesi social dhe familjar (28.12.2026);
- 1.29. Projekt Udhëzim Administrativ për qasjen e Ministrisë së Drejtësisë në Sistemin e Evidencës Penale (29.05.2026);
- 1.30. Projekt Udhëzim Administrativ për tarifat e administratorëve falimentues (30.04.2026);
- 1.31. Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën e mbajtjes së trajnimit, kushtet për të trajnuarit, kompensimin, si dhe rregullat për kandidatët të cilët e kanë kaluar provimin për noterë (30.06.2026);

1.32. Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën, përgjegjësinë, autorizimet dhe të drejtat e qasjes dhe administrimit të SIPL (31.03.2026);

1.33. Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën, përgjegjësinë, autorizimet dhe të drejtat e qasjes së noterëve në sistemin informativ noterial si dhe shkëmbimin e informatave me institucionet tjera (30.03.2026);

1.34. Projekt Udhëzim Administrativ për Regjistrin Elektronik të Testamenteve (31.03.2026);

1.35. Projekt Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores (ZKM) nr 03/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin Sprovues të Kosovës (31.03.2026);

1.36. Projekt Rregullore për klasifikimin e vendeve të punës për nëpunësit e shërbimeve publike në Institutin për Mjekësinë Ligjore (31.03.2026);

1.37. Projekt Udhëzim Administrativ për ndryshim plotësimin e Udhëzimit Administrativ MD - Nr.06/20219 për trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësuesve (29.05.2026);

1.38. Projekt Kodi Etik për Ofruesit e Shërbimeve Sociale dhe Familjare (29.05.2025).

3. Obligohen Agjencitë/Departamentet/Divizionet/Njësitë përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e projektit fillestar të akteve nënligjore nga pika 2 e këtij vendimi, dhe atë si në vijim:

3.1. Avokatura Shtetërore, projekt aktin nënligjor nga pika 1.1;

3.2. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, projekt aktet nënligjore nga pika 1.2 dhe 1.3;

3.3. Instituti për Mjekësi Ligjore, projekt aktet nënligjore nga pika 1.13 dhe 1.36;

3.4. Shërbimi Sprovues i Kosovës, projekt aktet nënligjore nga pika 1.5 dhe 1.35;

3.5. Departamenti Ligjor, projekt aktet nënligjore nga pika 1.4, 1.14, 1.29;

3.6. Departamenti për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, projekt aktet nënligjore nga pika 1.15 - 1.28 dhe 1.38;

3.7. Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika, projekt aktet nënligjore nga pika 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 1.12, 1.30, 1.31, 1.32, 1.33, 1.34 dhe 1.37.

4. Projekti fillestar sipas paragrafit 3 të këtij Vendimi, i përfunduar i dërgohet Departamentit Ligjor për shqyrtim sipas afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi.

5. Departamenti Ligjor pas përfundimit të shqyrtimit e procedon gjithë dokumentacionin për shqyrtim dhe miratim në pajtim me Rregulloren nr. 17/2024 të Punën së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Blerim SALLAHU

Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Udhëheqësve të Agjencive/Departamenteve/Divizioneve/Njësi;
- Kabinetit të Ushtruesit në Detyrë të Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Zyrës Ligjore të ZKM-së;
- Departamentit Ligjor/MD; dhe
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.